

Prishtina, 30 maj 2007

Rishqyrtimi i vendimeve D_29_2006, D_39_2007 dhe D_41_2007

Shënim mbi historikun

1 Hyrje

Ky shënim përmbledh historikun e Vendimit të ZRRE-së mbi rishqyrtimin e Vendimeve D_29_2006 të datës 21 Dhjetor 2006 mbi “Të hyrat e lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a” për periudhën e shqyrtimit të çmimeve 2007-2009”, D_39_2007 të datës 15 mars 2007 “Mbi miratimin e tarifave të reja me pakicë të KEK Sh.a” dhe D_41_2007 të datës 15 mars 2007 “Mbi miratimin e tarifave të propozuara të transmisionit për KOSTT Sh.a”.

Pas nxjerrjes së këtyre vendimeve, është kërkuar një rishqyrtim nga KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a në bazën se informacioni i ri sugjeronte që të hyrat e lejuara mund të jenë më të vogla se ato që është kërkuar nga secila entitet për vitin 2007 sipas vendimeve nga pika 1.

Gjatë periudhës konsultative, ZRRE ka nxjerrë Vendimin D_47_2007 më 7 maj 2007. Ky vendim përcakton që rishqyrtimi është arsyetuar dhe i fton palët për komente mbi përshtatjet për të hyrat e lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a dhe amendamentet përkatëse që kërkohen për tarifën e miratuara me pakicë dhe të transmisionit. ZRRE po ashtu ka ftuar KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a t’i dorëzojnë propozimet e tyre për ndryshim të tarifave të miratuara. Këto janë pranuar dhe publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së (www.ero-ks.org).

Seksionet pasuese të këtij shënimi përmbledhin arsyetimin për ndryshimet të cilat ZRRE i propozon për t’i bërë gjatë rishqyrtimit të hyrave të lejuara për KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a, ndryshimet rezultuese që ZRRE propozon për tarifën e miratuara me pakicë dhe të transmisionit dhe dokumenteve të pranuar si pjesë e konsultimeve mbi rishqyrtimin.

2 Rishqyrtimi i të hyrave të lejuara

Arsyetimi i siguruar për të rishqyrtuar të hyrat e lejuara dhe propozimi fillestar I ZRRE-së mbi këto është paraqitur në një shënim përcjellës të Vendimit D_47_2007. Asnjë koment nuk është pranuar mbi këto propozime. Prandaj ZRRE, nuk sheh ndonjë arsye të modifikojë propozimet fillestare.

2.1 KEK Sh.a

KEK Sh.a ka kërkuar që ZRRE t’i rishqyrtojë të hyrat e lejuara të miratuar dhe tarifën me pakicë duke marrë parasysh:

- Pamundësinë e KEK Sh.a për të ndërmarrë punën e rehabilitimit në Kosova A3 dhe A4 në vitin 2007, që rezulton në reduktimin e shpenzimeve kapitale prej EUR 76.46 milion prej atyre të planifikuara më herët. Në mënyrë që të zbuten rritjet e tarifave me pakicë dhe si përgjigje për shqetësimet e publikut, KEK Sh.a ka kërkuara që të hyrat e lejuara dhe si pasojë e tyre, tarifatat e miratuara me pakicë për vitin 2007, të përshtaten në përputhje me këtë.
- Bindjen e KEK Sh.a që reduktimet e mëtejme në humbjet komerciale prej nivelit të planifikuar prej 22% për vitin 2007 janë të mundura. KEK Sh.a ka treguar se mund të arrihet së paku një reduktim prej 1%.
- Pritjen e KEK Sh.a që do të pajtohej me KOSTT Sh.a për një zbritje prej 5% në tarifatat për shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit dhe shërbimeve të tij si operator sistemit dhe i tregut. Kjo zbritje do të përfaqësonte kontributin e KOSTT Sh.a në nevojën e perceptuar, për të zbutur rritjet e tarifave me pakicë¹.
- Qëllimin e KEK Sh.a, në kundërshtim me aplikacionin e tyre të mëhershëm, për të mbajtur tarifatat për konsumatorët shtëpiak me njehsorët dy tarifor, për shkak të shqetësimeve të tyre dhe për shkak të mungesës së pranueshmërisë për të kaluar në ngarkim sipas sistemit një-tarifor dhe problemet e mundshme të përballeshmërisë së pagesave për konsumatorët shtëpiak me të hyra të ulëta².

ZRRE propozon të miratojë k]to përshtatje tek të hyrat e lejuara. Kjo do të rezultonte me ndryshimin në vijim për të hyrat e lejuara që të mbulohen prej tarifave të rregulluara me pakicë, për vitin 2007:

Tabela 1: Të hyrat e lejuara të rishikuara për KEK Sh.a, 2007

<i>EUR 000</i>	Miratar (21 Dhjetor 2006)	Rishqyrtimi i propozuar
Të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga tarifatat e rregulluara për vitin 2007	141 899	134 982

2.2 KOSTT Sh.a

KOSTT Sh.a, në letrën dërguar ZRRE-së më datë 7 maj 2007, ka identifikuar përshtatjet në vijim për të hyrat e lejuara për vitin 2007 që marrin në konsideratë:

Reduktimet në kostot e personelit prej EUR 150,000.

Reduktimet në kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse prej EUR 210,000.

Reduktimet në kostot e mirëmbajtjes prej EUR 120,000,

¹ Obligimi i KOSTT që të mos diskriminojë konsumatorët kërkon që çfarëdo zbritje po ashtu të aplikohet për konsumatorët e privilegjuar.

² Ka dëshmi anekdotike se konsumatorët shtëpiak kanë marrë masa që t'i reduktojnë kostot e energjisë duke i kaluar periudhat e konsumimit në periudhat e tarifave më të ulëta.

ZRRE propozon të miratojë këto përshtatje për të hyrat e lejuara.

Kostot lidhur me rrjetin (duke përfshirë edhe ato të personelit dhe mirëmbajtjes) për KOSTT Sh.a janë të mbuluara përmes të hyrave që janë “zbutur” gjatë një periudhe tri vjeçare. Prandaj, përshtatjet rezultuese për të hyrat e lejuara nuk do të ndodhin domosdoshmërisht në vitin 2007, por do të rezultojnë në ndryshimet tek të hyrat e lejuara gjatë periudhës 2007-09. Prandaj, ZRRE ka rillogaritur të hyrat e “zbutura” për rrjetin e KOSTT Sh.a, duke marrë parasysh reduktimet tek kostot e lejuara të propozuara nga KOSTT Sh.a³. Duke bërë këtë, ka kërkuar të sigurojë se shumica e reduktimeve bie në vitin e parë të periudhës së zbutur tri vjeçare (2007).

Të hyrat rezultuese të propozuara e të miratuara për KOSTT Sh.a janë paraqitur më poshtë:

Tabela 2: Të hyrat e lejuara të rishqyrtuara për KOSTT Sh.a, 2007

<i>EUR 000</i>	Miratuar (21 Dhjetor 2006)	Rishqyrtimi i propozuar
Të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga tarifat e rregulluara të transmisionit për vitin 2007	13 678	13 190

3 Tarifat me pakicë të ndryshuara

Ky paragraf shqyrton propozimet e ZRRE-së për tarifa të reja me pakicë të cilat përputhen me të hyrat e lejuara të përshtatura gjatë rishqyrtimit. Për t’ju shmangur hutisë, në këtë shënim janë përdorur termet në vijim:

- i) **Tarifat ekzistuese** i referohet tarifave të aprovuara më 1 korrik 2000, të cilat tashmë janë në fuqi.
- ii) **Tarifat e aprovuara** i referohet tarifave të reja me pakicë të aprovuara nga ZRRE-ja më 15 mars 2007, implementimi i të cilave është ndërprerë me që procesi i rishqyrtimit ka qenë në zhvillim.
- iii) **Tarifat e propozuara të KEK-ut** i referohet tarifave të reja me pakicë të propozuara nga KEK Sh.a më 16 maj 2007, të cilat përputhen me të hyrat e lejuara të përshtatura.
- iv) **Tarifat e propozuara të ZRRE-së** i referohet tarifave të reja me pakicë të propozuara nga ZRRE në këtë shënim.

Për secilën strukturë të tarifave, është siguruar informacion krahasues mbi:

- v) Tarifën mesatare për secilën kategori të konsumatorëve dhe ndryshimin nga nivelet ekzistuese.

³ Kjo është bërë duke ri-caktuar çmimin fillestar të përshtatjes (P_0) dhe faktorin vjetor të përshtatjes (X-faktor) në mënyrë që vlera e tanishme e të hyrave të lejuara gjatë periudhës 2007-09 të jetë e barabartë me vlerën e tanishme të kostos së lejuar, të gjitha janë zbritur në koston e vlerësuar të kapitalit për KOSTT Sh.a

- vi) Tarifën mesatare për konsumatorët në kategorinë 5 (konsumatorët shtëpiak të kyçur në tension 0.4kV ‘me njehsorët dy tarifor), me konsum mujor prej 200kWh (të definuar si konsumatorë me ‘nevoja minimale’), prej 600kWh (përafërsisht të barabartë me konsumatorin ‘mesatar’) dhe prej 1000 kWh (konsumatorët e ‘mëdhenj’ që furnizohen me limitin më të lartë të bllokut përkatës -600kWh për konsumatorët shtëpiak).

Ky informacion krahasues është siguruar në dy baza të ndryshme:

- vii) **‘Viti i plotë’**, që tregon ndryshimet që do të rezultojn nëse tarifat e reja me pakicë aplikoheshin nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2007. Për konsumatorin i cili llogaritet se si do të ndikojë në faturat e tij, ky do të jetë ndikimi i perceptuar. Kjo po ashtu është masa e përshtatshme nëse shqyrtimi i ardhshëm i çmimeve dhe hyrja e tarifave për 2008 pritet të shtyhet dhe në këtë mënyrë tarifat e reja me pakicë, do të vazhdojnë të aplikohen për pjesën e parë të vitit 2008.
- viii) **‘Viti i pjesërishtëm’** që tregon ndryshimet të cilat do të rezultojn nëse tarifat e reja me pakicë do të aplikoheshin nga 1 prilli deri më 31 dhjetor 2007, me tarifat ekzistuese të cilat aplikohen përpara kësaj date. Ky është ndryshimi i tanishëm i pritur në faturat e konsumatorëve për vitin në tërësi, pas lejimit të hyrjes së shtyrë të tarifave të reja.

Sipas tarifave të propozuara nga ZRrE-ja, të ardhurat e mbuluara prej secilës kategori të konsumatorëve prej 0 në 4 dhe 8 (konsumatorët jo-shtëpiak), mbesin të pandryshuara nga ato **Tarifa të aprovuara**. Të ardhurat totale të mbuluara nga kategoritë e konsumatorëve prej 5 në 7 (konsumatorët shtëpiak) janë reduktuar që të jenë në përputhshmëri me vlerën e tërësishme të zvogëluar të ardhurave të lejuara e që i përkasin pjesës së rregulluar të hyrave gjatë këtij rishqyrtimi.

Përshtatjet e aplikuara për kategoritë e konsumatorëve individual janë përshkruara më poshtë.

Kategoria 0 – 110kv

Nuk ka ndryshim nga **Tarifa të aprovuara**.

Kategoria 1 – 35kV

Nuk ka ndryshim nga **Tarifa të aprovuara**.

Kategoria 2 – 10kV

Nuk ka ndryshim nga **Tarifa të aprovuara**.

Kategoria 3 – 0.4kV komerciale të mëdhenj

Gjatë diskutimeve më KEK Sh.a, është paraqitur nevoja për rivendosjen e fuqisë së angazhuar dhe tarifës përkatëse, për këta konsumatorë. Kjo i përgjigjet shqetësimeve të KEK Sh.a, që të hyrat e tyre janë shumë të varura vetëm nga energjia dhe pikëpamjes së rishqyrtuar të KEK Sh.a, se keqpërdorimi i maksigrafëve nuk është një problem serioz që mos të jetë pjesë e strukturës tarifore edhe fuqia.

Për nevojën e kërkesës reale është aplikuar një Faktor i përgjithshëm shkallëzues është zbatuar në çmimet e fuqisë dhe energjisë gjatë llogaritjes në model, për të siguruar se të hyrat totale të mbuluara nga kjo kategori konsumatorësh, janë të barabarta me ato të mbuluara sipas **Tarifa të aprovuara**. Kjo rezulton në reduktimin e çmimeve të energjisë sipas **Tarifa të aprovuara**, e që të kompensohet nga të hyrat që do të realizohen nga rivendosja e fuqisë së angazhuar me tarifë përkatëse.

Specifikimi i të hyrave që mbulohen nga secili lloj i çmimit me pakicë për këtë kategori të konsumatorëve duke edhe ndryshimet nga paragrafi paraprak, është paraqitur në Figurën 1. Pjesa totale e të hyrave me pakicë e mbuluara për tërë vitin nga ngarkesa fikse dhe tarifa për fuqinë e angazhuar do të jetë 13%, krahasuar me 15% sipas **Tarifave të propozuara të KEK-ut**, 11% sipas **Tarifave të aprovuara** dhe 10% sipas **Tarifat ekzistuese** .

Figura 1: Ndarja e të hyrave sipas tipit të tarifës

	Krahasimi vjetor				Krahasimi i pjesëshëm i vitit			
	Ekzistuese	Aprovuar (15 Mars 2007)	ZRrE Propozuar (18 Maj 2007)	KEK Propozuar (16 Maj 2007)	Ekzistuese	Aprovuar (15 Mars 2007)	ZRrE Propozuar (18 Maj 2007)	KEK Propozuar (16 Maj 2007)
Tarifa fikse	3%	8%	9%	9%	3%	7%	8%	8%
Tarifa fuqisë	7%	3%	4%	6%	7%	4%	5%	6%
Tarifa e energjisë	89%	89%	87%	85%	89%	89%	87%	86%
Tarifa e fuqisë reaktive	1%	0%	0%	0%	1%	1%	1%	1%

Kategoria 4 – 0.4kV komerciale të vegjël

Për këta konsumatorë ishte shprehur shqetësimi se dallimi në çmim i energjisë në mes të tarifës së lartë dhe asaj ulët (që përfshinë koston lidhur me fuqinë e angazhuar e që për konsumatorët tjerë industrial dhe komercial janë mbuluar përmes tarifës së posaçme për fuqinë e angazhuar) është i pamjaftueshëm. Prandaj këto janë përshtatur, duke i lënë të pandryshuara të hyrat totale të mbuluara prej kësaj kategorie, duke zbatuar koeficient të njëjtë (2) si në rastin e konsumatorëve shtëpiak me matës dy-tarifor (kategoria 5).

Kategoria 5 – 0.4kV shtëpiake (njehsor dy tarifor)

Sistemi dy-tarifor është rivendosur për këta konsumatorë, që zëvendëson atë vetëm një-tarifore të vendosur për kohë të caktuar, sipas **Tarifave të aprovuara** me kërkesë të KEK Sh.a. Kjo pasqyron shqetësimet e KEK-Sh.a lidhur me kundërshtimin e suspendimit të sistemit dy-tarifor dhe shqetësimet e ZRRE-së se këta konsumatorë nuk do të kenë më rast t'i përshtatin modelet e konsumimit për të reduktuar faturat e energjisë elektrike (dhe po ashtu të reduktojnë sistemin total të koston).

Ngarkesa fikse (konsumatorit) është rritur në €2/konsumator/muaj (€24/konsumtor/vit). Kjo i përgjigjet shqetësimeve lidhur me vështirësitë praktike për të implementuar çmimin e mëparshëm (prej €20/konsumator/vit) sipas **Tarifave të aprovuara** duke shfrytëzuar sistemin e tanishëm të faturimit të KEK Sh.a.

Me këto përshtatje, kostoja reale e çmimit të energjisë së kalkuluar në modelin e konsumatorëve në bllokun e parë(0-200kWorë/muaj) është shkallëzuar nga një faktor i përgjithshëm, në mënyrë që tarifa mesatare për konsumatorin që konsumon sasinë më të madhe të këtij blloku (p.sh. 200kWorë/muaj) mbetet e pandryshuar nga niveli sipas **Tarifave ekzistuese** (kalkuluar në bazë të vitit të plotë). Kjo është në pajtueshmëri me qasjen e miratuar nga **Tarifat e aprovuara**. Kalkulimi përfshinë të gjitha çmimet e pagueshme nga konsumatori, duke përfshirë edhe çmimet e energjisë, çmimet e fuqisë dhe çmimet fikse të konsumatorëve.

Çmimet e energjisë së koston reale të kalkuluar në model për konsumatorët në bllokun e dytë (201-600kWorë/muaj) janë shkallëzuar nga një faktor i përgjithshëm, në mënyrë që tarifa mesatare për një konsumator që konsumon sasinë më të madhe të këtij blloku mbetet e pandryshuar nga niveli sipas **Tarifave ekzistuese** (të kalkuluar në bazë të vitit të plotë). Kjo pasqyron pikëpamjen e ZRRE-së se konsumatori shtëpiak mesatar (me konsumim të e për afërsisht 570kWorë/muaj) do t'i shohin tarifat e tyre në përgjithësi të pandryshuara.

Pagesat për energji që reflektojnë koston, në modelin për konsumatorët në bllokun e tretë (>600kWh/muaj) janë shkallëzuar nga një faktori i përgjithshëm në mënyrë që totali i të hyrave të mbledhura nga tarifat e rregulluara për vitin 2007 janë në përputhje me ato të aprovuara nga ZRRE-ja pas rishqyrtimit (duke marrë parasysh përshtatjen me tarifat e konsumatorëve të tjerë, si më poshtë).

Kategoria e amvisërisë 6 – 0.4kV (njehsorët një tarifor)

Të njëjtat ngarkesa fikse (të konsumatorëve) janë aplikuar si për konsumatorët nën kategorinë 5. Në **Tarifat e aprovuara**, çmimet për konsumatorët në këtë kategori janë vendosur të njëjta me ato të konsumatorëve në kategorinë 5 (të cilat përkohësisht kanë

qenë zhvendosur si një tarifor). Kjo nuk qëndron më, pas ndryshimeve që janë përshkruar më lartë për çmimin e konsumatorëve në kategorinë 5. Në vend të saj, çmimet e energjisë për konsumatorët e kësaj kategorie janë vendosur në atë mënyrë që “sinjalet e çmimit” për këta konsumatorë të jenë të njëjta siç janë vendosur në kategorinë 5, si në vazhdim:

- ix) Raporti i çmimit të energjisë në secilin bllok me atë vijues (p.sh. çmimi relativ i energjisë për konsum i bllokut të parë me bllokun e dytë) është njëjtë si për konsumatorët e kategorisë 5.
- x) Raporti i çmimit të energjisë në periudhën e lartë(tarifa dimërore) nën secilin bllok është e njëjtë me atë të periudhës së ulët(tarifa verore) të konsumatorëve në kategorinë 5.

Çmimet e energjisë për secilin bllok pastaj janë rregulluar duke u zvogëluar në mënyrë që çmimi mesatar që duhet të paguhet nga konsumatorët në këtë kategori të bie përafërsisht për 5%, për të qenë edhe më ekuivalent me çmimet e konsumatorëve nën kategorinë 5, (çmimi efektiv i energjisë në tarifatat ekzistuese – shuma e energjisë dhe pagesa për fuqi – e paguar nga këta konsumatorë është dukshëm më e lartë se ajo e paguar nga konsumatorët e kategorisë 5).

Kategoria e konsumatorëve shtëpiak 7 – 0.4kV (të pamatur)

Çmimet reale mujore të kalkuluara në këtë model për këta konsumator janë shkallëzuar nga i njëjti faktor siç është aplikuar tek konsumatorët nën kategorinë 5 të bllokut të njëjtë (p.sh. çmimet reale për konsumatorët në bllokun e parë për të dy kategoritë 5 dhe 7 janë shumëzuar me faktorin shkallëzues prej 0.83).

Kategoria 8 – Ndricimi Publik

Nuk ka ndryshim nga tarifatat e aprovuara. Tarifatat që kanë rezultuar janë paraqitur në Figurën 2, së bashku me tarifatat ekzistuese dhe tarifatat e miratuara. Figurat në vijim (Figura 3 dhe Figura 4) paraqesin ndryshimet mesatare që kanë rezultuar për secilën kategori të konsumatorëve në bazë të vitit të plotë dhe një pjese të vitit dhe ndryshimet e rezultuara në mesataren e tarifave për konsumatorët e kategorisë 5 në nivele të ndryshme të konsumit në bazë të vitit të plotë dhe një pjese të vitit.

Figura 2: Tarifrat me pakicë të propozuara nga ZRRE

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Ekzistuese		Aprovuar (15 Mars 2007)		Aprovuar		
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët	
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00		34.00		
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,150.00	895.00	519.00	519.00	519.00	519.00	
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	2.68	2.11	6.03	1.78	6.03	1.78	
		Energjia reaktive (Q)	€/kWh	Tarifa e ulët	1.34	1.09	2.50	1.47	2.50	1.47	
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				30.00		30.00		
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,278.00	959.00	540.00	540.00	540.00	540.00	
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	3.20	2.56	6.30	2.73	6.30	2.73	
		Energjia reaktive (Q)	€/kWh	Tarifa e ulët	1.60	1.28	3.33	2.47	3.33	2.47	
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00		34.00		
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,278.00	959.00	466.00	466.00	466.00	466.00	
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	3.52	2.81	7.07	3.15	7.07	3.15	
		Energjia reaktive (Q)	€/kWh	Tarifa e ulët	1.76	1.41	3.81	2.87	3.81	2.87	
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				29.00		29.00		
		Fuqia e angazhuar	€/kW		852.00	631.00			270.00	270.00	
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.11	3.83	9.83	5.40	7.85	4.36	
		Energjia reaktive (Q)	€/kWh	Tarifa e ulët	2.56	1.92	6.15	5.08	4.95	4.11	
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00		34.00		
		Fuqia e angazhuar	€/kW		253.00	189.00					
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.57	5.68	9.73	6.23	9.68	6.26	
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	9.47	6.94	11.05	6.35	11.64	7.63	
5	0.4kV matësi i 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				20.00		24.00		
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh								
		<200 kWh/muaj (Biloku i parë)	€/kWh		144.00	115.00				0.00	0.00
		200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë)	€/kWh		144.00	115.00				0.00	0.00
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kWh		192.00	144.00				0.00	0.00
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.80	3.83	3.47	2.49	4.42	3.17	
		<200kWh/muaj (Biloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e ulët	2.40	1.92	3.47	2.49	2.21	1.58	
		200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.80	3.83	4.76	3.42	5.97	4.28	
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e ulët	2.40	1.92	4.76	3.42	2.99	2.14	
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.67	5.75	8.43	6.06	8.67	6.21	
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e ulët	3.83	2.88	8.43	6.06	4.33	3.11	
		6	0.4kV matësi i 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				20.00		24.00
Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh										
<200 kWh/muaj (Biloku i parë)	€/kWh				144.00	115.00				0.00	0.00
200-600 kWh/muaj (Biloku i dytë)	€/kWh				144.00	115.00				0.00	0.00
>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kWh				192.00	144.00				0.00	0.00
Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh			Tarifa e vetme	3.99	3.20	3.47	2.49	3.94	2.82	
<200kWh/muaj (Biloku i parë) prej të cilit:	€/kWh			Tarifa e vetme	3.99	3.20	4.76	3.42	5.32	3.81	
>600 kWh/muaj (Biloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh			Tarifa e vetme	6.39	4.80	8.43	6.06	7.72	5.53	
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj	€/konsumator/muaj		20.00	20.00	23.00		20.00		
		Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		36.00	36.00	42.00		36.00		
		Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		61.00	61.00	71.00		61.00		
8	Ndiri qimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00		34.00		
		>600 kWh/muaj (Biloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	8.21	6.31	7.82	7.82	7.82	7.82	

a Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00-22:00 e Hënë-e Shtunë gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 e Hënë-e Shtunë gjatë sezonës së ulët
b Aty ku nuk është instaluar maksigrafi (kategoria 4-6) kërkesa ekzistuese llogaritet si volumi i energjisë së konsumuar sipas tarifës së lartë duke pjestuar me 100
c Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero
d Sipas tarifave ekzistuese, kjo tarifë aplikohet për konsumin >800kWh/muaj

Figura 3: Ndryshimet mesatare të tarifave – të propozuara nga ZRRE

Grupi tarifor		Ekzistuese €/kWh	Aprovuara (15 Mars 2007)		Tarifa Mesatare			
			€/kWh	Ndrysh.	Propozuar nga ZRrE (18 Maj 2007)	Propozuar nga KEK (16 Maj 2007)		
					€/kWh	Ndrysh.	€/kWh	Ndrysh.
0	110kV	3.45	3.69	6.9%	3.69	6.9%	3.52	1.9%
1	35kV	4.46	5.17	15.8%	5.17	15.8%	5.06	13.3%
2	10kV	5.37	6.06	12.8%	6.06	12.8%	5.94	10.7%
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzime të fuqisë reaktive)	5.84	7.06	20.8%	6.91	18.3%	6.87	17.6%
4	0.4kV Kategoria II	8.64	8.67	0.3%	8.67	0.3%	8.67	0.3%
5	0.4kV (shtëpiak 2-njehsor dy vlerësh) (c)	4.37	4.95	13.2%	4.33	-1.0%	4.41	1.0%
6	0.4kV (shtëpiak, 1-njehsor njëvlerësh) (c)	5.55	5.02	-9.6%	5.26	-5.2%	4.60	-17.2%
5-6	<i>Të gjithë konsumatorët shtëpiak me matës</i>	4.54	4.96	9.1%	4.46	-1.8%	4.44	-2.3%
7	0.4kV (Konsumatorët shtëpiak pa matës)	4.23	4.92	16.2%	4.23	0.0%	4.24	0.1%
Të gjithë konsumatorët shtëpiak		4.53	4.96	9.5%	4.45	-1.7%	4.43	-2.2%
8	Ndriçimi publik	7.33	7.96	8.6%	7.96	8.6%	7.96	8.6%
Tarifa mesatare për të gjithë konsumatorët		5.07	5.50	8.5%	5.13	1.2%	5.10	0.6%
Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi prej 1 Prillit 2007)								
Grupi tarifor		Ekzistuese €/kWh	Aprovuara (15 Mars 2007)		Tarifa Mesatare			
			€/kWh	Ndrysh.	Propozuar nga ZRrE (18 Maj 2007)	Change	Propozuar nga KEK (16 Maj 2007)	Change
					€/kWh		€/kWh	
0	110kV	3.45	3.36	-2.7%	3.36	-2.7%	3.36	-2.7%
1	35kV	4.46	4.72	5.8%	4.72	5.8%	4.74	6.3%
2	10kV	5.37	5.59	4.1%	5.59	4.1%	5.59	4.1%
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzime të fuqisë reaktive)	5.84	6.44	10.3%	6.44	10.3%	6.44	10.4%
4	0.4kV Kategoria II	8.64	8.56	-0.9%	8.56	-0.9%	8.56	-0.9%
5	0.4kV (shtëpiak 2-njehsor dy vlerësh) (c)	4.37	4.74	8.5%	4.32	-1.3%	4.39	0.4%
6	0.4kV (shtëpiak, 1-njehsor njëvlerësh) (c)	5.55	5.15	-7.2%	5.32	-4.2%	4.89	-11.9%
5-6	<i>Të gjithë konsumatorët shtëpiak me matës</i>	4.54	4.80	5.7%	4.46	-1.8%	4.46	-1.8%
7	0.4kV (Konsumatorët shtëpiak pa matës)	4.23	4.75	12.2%	4.23	0.0%	4.24	0.1%
Të gjithë konsumatorët shtëpiak		4.53	4.80	5.9%	4.45	-1.7%	4.45	-1.8%
8	Ndriçimi publik	7.33	7.81	6.5%	7.81	6.5%	7.81	6.5%
Tarifa mesatare për të gjithë konsumatorët		5.07	5.29	4.4%	5.05	-0.5%	5.05	-0.5%
Totali i të ardhurave në vit (€000s)		135,688	141,899		135,048		135,049	
Të ardhurat e lejuara për tërë vitin (€000s)		135,046	135,046		135,046		135,046	
Ndryshimi (€000s)		642	6,853		2		2	

Figura 4: Ndryshimet e tarifave për konsumatorët shtëpiak – të propozuara nga ZRRE

Aprovuar (15 Mars 2007)

0.4 kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy vlerëshe)	Konsumimi mujor kWh	Ekzistuese		Krahasimi vjetor			Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi 1 Prill 2007)				
		Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.	Fatura (periudha e 1)	Fatura (periudha e 2)	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.
		€	€/kWh	€	€/kWh		€	€	€	€/kWh	
Nevoja minimale	200	92	3.84	93	3.86	0.4%	27	65	92	3.84	0.0%
Konsumatori mesatar	600	277	3.84	292	4.05	5.4%	81	203	284	3.94	2.7%
Konsumatorët e mëdhenj	1,000	508	4.23	652	5.44	28.5%	154	441	595	4.96	17.2%

Propozuar nga KEK (16 Maj 2007)

0.4 kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy vlerëshe)	Konsumimi mujor kWh	Ekzistuese		Krahasimi vjetor			Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi 1 Prill 2007)				
		Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.	Fatura (periudha e 1)	Fatura (periudha e 2)	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.
		€	€/kWh	€	€/kWh		€	€	€	€/kWh	
Nevoja minimale	200	92	3.84	101	4.22	9.8%	27	73	100	4.15	8.0%
Konsumatori mesatar	600	277	3.84	269	3.74	-2.6%	81	189	270	3.75	-2.3%
Konsumatorët e mëdhenj	1,000	508	4.23	554	4.62	9.1%	154	378	532	4.43	4.7%

Propozuar nga ZRrE

0.4 kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy vlerëshe)	Konsumimi mujor kWh	Ekzistuese		Krahasimi vjetor			Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi 1 Prill 2007)				
		Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.	Fatura (periudha e 1)	Fatura (periudha e 2)	Fatura vjetore	Çmimi mesatar	Ndrysh.
		€	€/kWh	€	€/kWh		€	€	€	€/kWh	
Nevoja minimale	200	92	3.84	92	3.84	0.0%	27	65	92	3.84	0.1%
Konsumatori mesatar	600	277	3.84	276	3.84	-0.1%	81	193	274	3.81	-0.9%
Konsumatorët e mëdhenj	1,000	508	4.23	544	4.54	7.2%	154	371	525	4.37	3.4%

4 Tarifat e transmisionit të ndryshuara

ZRRE propozon të mos bëjë ndryshime në caktimin e të hyrave të lejuara që duhet të mbulohen prej tarifave të transmisionit ndërmjet niveleve të tensionit dhe tipeve të ngarkesave. ZRRE po ashtu nuk propozon të bëjë ndryshime në strukturën e tarifave të transmisionit.

Qasja për kalkulimin e tarifave të ndryshuara të transmisionit që merr parasysh të hyrat e lejuara të ndryshuara, të propozuara për KOSTT Sh.a mbetet e pandryshuar nga ajo e mëhershme dhe e përshtatur në aplikacionin origjinal të KOSTT Sh.a për miratimin e tarifave të transmisionit, të dorëzuar në janar 2007.

Tarifat e transmisionit të ndryshuara janë paraqitur më poshtë në Figurën 5:

Figura 5: Tarifat e transmisionit të propozuara nga ZRRE

Tarifat	Njësia	Miratuara (15 mars 2007)	të ndryshuara
Tarifa per rrjete			
- 400/220kV	EUR / kW /vit ^a	3.119	3.025
- 110kV	EUR / kW /vit ^b	7.001	6.792
Tarifa per operim te sistemit	EUR / MWh	0.872	0.849
Tarifa per operim te tregut	EUR /MWh	0.013	0.014

a Aplikohet për mesataren e nevojës në kohën e pesë nevojave më të larta maksimale të sistemit në vit. Vetëm furnizuesve ju lejohet kjo ngarkesë.

b Përfshin ngarkesën prej 400/220kV

5 Parashtrësit e pranuar dhe komentet

Përveç KEK Sh.a dhe KOSTT Sh.a, janë pranuar komente edhe nga Kompania e Ujësjetësimit Rajonal “Prishtina” (KURP) dhe Kompanitë Publike për Furnizim me Ujë, nëpërmjet Shoqatës së Ujësjetësimit të Kosovës (SHUKOS). Të dy komentet janë të lidhur me rritjet e mëdha të faturave të energjisë për kompanitë e ujësjetësimit që priten me tarifat e propozuara. Ishin paraqitur shqetësime se pa përshtatje këto rritje do të kërkonin ndihma të mëdha prej Qeverisë apo rritje në tarifat e ujit.

SHUKOS ka kalkuluar këto rritje në tarifat e miratuara si vijon:

- Prishtina 23.35%
- Mitrovica 24.98%
- Gjakova 19.38%

- Gjilani 21.96%
- Peja 21.55%

KURP ka kalkuluar rritjen e faturës së energjisë në tarifatat e propozuara të KEK-ut të që është 21.92%.

Këto rritje rezultojnë nga rritja e vogël e përgjithshme në tarifatat mesatare për këta për konsumatorë industrialë dhe komercialë dhe rebalancimin e tarifave për këta konsumatorë ndërmjet fuqisë së angazhuar dhe të energjisë që të pasqyrojnë më mirë kontributin e kostos së fuqisë me atë energjisë në koston totale të të KEK Sh.a.

ZRRE çmon interesimin e SHUKOS dhe KURP. ZRRE-ja thekson vëren se sipas tarifave të propozuara të ZRRE-së, këto shqetësime pjesërisht qëndrojnë (rritja në faturën e energjisë së KURP-it është kalkuluar del të jetë 10.98% në vend të vlerës më të lartë të kalkuluar nga KURP sipas tarifave të propozuara nga KEK-u).

ZRRE thekson se detyra e saj ligjore kërkon të paraqes tarifa të koston reale që duhet të sigurojë mbrojtje adekuatë të konsumatorëve. Nuk ka ndonjë detyrë tjetër specifike, që të merr parasysh ndikimin e vendimit të vet tek konsumatorët e ndërmarrjeve tjera. Vërtet, do të ishte e papërshtatshme që të bënte një gjë të tillë - sepse kjo do të çonte kah favorizimi i një grupi të konsumatorëve që është në kundërshtim me obligimet e saja ligjore që të mos lejojë diskriminim.

Prandaj, ZRRE nuk konsideron se mund të reduktojë tarifatat që i ngarkojnë furnizuesit e ujit pa i reduktuar çmimet e të gjithë konsumatorëve të të njëjtës kategori. ZRRE-ja nuk ka bazë për të bërë një reduktim të tillë me informacionin që i është siguruar në nivelin dhe strukturën e koston së KEK Sh.a dhe duke bërë një gjë të tillë do t'i shkelte detyrat e saja ligjore.